



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 23.05.2023

Nr: 126

Ora: 13:25

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR.63, DATË 22.05.2023 TË DEPOZITUAR NË KQZ NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "ALEANCA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 23.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Subjekti zgjedhor "Aleanca Demokristiane e Shqipërisë", përfaqësuar nga z. Zef Bushati dhe z. Petrit Dedaj

**OBJEKT:**

1. Kundërshtim i vendimit nr. 260, datë 16.05.2023 të KZAZ nr. 07, bashkia Pukë "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Pukë".
2. Rivlerësimin e votave të vlefshme dhe të pavlefshme të subjekteve në kutitë e votimit për këshillin bashkiak në KZAZ nr. 07, bashkia Pukë, qarku Shkodër, si dhe ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit



për këshillin e bashkisë Pukë, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga procesi i rivlerësimit të votave.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

#### **VËREN:**

Subjekti zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, përfaqësuar nga z. Zef Bushati ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 63 regj., datë 22.05.2023. Në mbledhjen e datës 23.05.2023, ora 13:25, pas relatimit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa ankimore nr. 63 i plotësonte elementet e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 63, datë 20.04.2023 të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 24.04.2023, ora 12:30.
3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palës në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative

**Elvis**            **ÇEFA**                            -            **Relator**

**Elvin**            **LAKO**                                -            **Anëtar**

**Ilirjan**           **RUSMALI**                           -            **Anëtar**

**Ledio**            **BRAHO**                              -            **Anëtar**

